1.2 Dhënia e tokës në shfrytëzim afatgjatë bëhet me qëllim të zbatimit të programit investiv (projektit) "Qendër tregtare dhe veprimtari shërbyesë e tipit mac-donalds"

Sipërfaqja tokësore

Neni 2

2.1 Toka ndërtimore i jepet në shfrytëzim afatgjatë investitorit në sipërfaqe prej 1.5 ha (një hektar e gjysmë) në ngastrën nr. 164/ fleta poseduese nr. 100 ZK: Konjuh, në pronësi të Komunës.

Vërejtje: Shifrimi i ngastrës bëhet me rastin e ndarjes fizike të sipërfaqes nga ngastra nr. 164

2.1.1 Toka ndërtimore jepet në lokacionin e përcaktuar me numër identifikues 4 sipas skicës së bashkangjitur kësaj kontrate.

2.1.2 Sipërfaqja e dhënë në shfrytëzim ka dimensionet 136 m x 200 m dhe kufiri në formë të hipotenuzës me gjatësi 242 m me shtrirje të lokacionit në pozicionin veri – jug me qasje në rrugën e I-rë dhe të II-të të brendshme.

2.2 Toka ndërtimore jepet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh – sipas dispozitave të Rregullores 2005/13

Rregullimi i tokës ndërtimore

Neni 3

3.1 Komuna me lidhjen e kësaj kontrate me shfrytëzuesin e tokës ndërtimore dhe marrjen e miratimit nga autoriteti qendror do të bëjë përcaktimin dhe ndarjen e ngastrës në sipërfaqe të caktuara sipas nenit 2.1.1 dhe 2.1.2 si dhe shënimin e kufinjëve të sipërfaqes ndërtimore përkatësisht ndarjen fizike të ngastrës.

3.1.1 Me realizimin e kushteve sipas nenit 3.1 të kësaj kontrate, kryesheri i Ekzekutivit nxjerr aktvendim për njohjen e të drejtës në shfrytëzim të tokës nga investitori si dhe caktohen obligimet e shërbimit kompetent komunal për ndarjen fizike të ngastrës sipas nenit 2 të kontratës.

3.1.2 Ndarja fizike e lokacionit nga shërbimi kompetent komunal bëhet në afatit e përcaktuar për përgatitje të dokumentacionit teknik.

3.2 Infrastruktura rrugore do të rregullohet në vijat e përcaktuara me Planin Rregullativ Ideor Urban për Zonën e Re Ndërtimore.

3.3 Për rregullimin e infrastruktures tjetër publike (elektrika, ujësjellësi dhe kanalizimi) Komuna do të hartojë projektet kryesore dhe ato do të realizohen me marrëveshje të veçantë me të gjithë investitorët pra edhe me pronarët privatë tokave në Zonën e Re Ndërtimore.

3.4 Komuna do të caktoj kushtet e lokacionit – urbane teknike për ndërtimin e objektit në afat prej 15 ditësh nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate bazuar në dokumentacionin teknik – projektin ideor të paraqitur nga investitori në konkursin publik.

3.4.1 Të gjitha efektet dhe pasojat juridike (afatet) sipas kësaj kontrate fillojnë të rrjedhin nga momenti i marrjes së pëlqimit nga autoriteti qendror.

3.4.2 Me marrjen e pëlqimit nga autoriteti qendror – investitori njoftohet brenda tri ditësh dhe nga dita e njoftimit zbatohet kjo kontrate.

3.4.3 Pas marrjes së njoftimit sipas dispozitës 3.4.2 investitori me kërkesë të veçantë inicon procedurën administrative për kushte të lokacionit, leje urbane dhe leje të ndërtimit.

3.5 Komuna ofron ndihmë dhe bashkëpunim të plotë me investitorët për të gjitha qështjet e duhura në përputhje me ligjet në fuqi dhe me këtë kontrate.

3.6 Komuna – DPU do të cakton mbikqyrësit zyrtar si për dokumentacionin teknik ashtu edhe për zbatimin e programit investiv.

3.6.1 Obligimet e mbikqyrësve janë të ndara sipas natyrës së punës dhe përfshijnë:

a) mbikqyrësi për dokumentacion teknik – detyrat:

- përcjellja e rregullimit të dokumentacionit teknik brenda afatit të përcaktuar;
- mbikqyrja dhe bashkëpunimi gjatë hartimit të dokumentacionit teknik;
- raportimi për kryerjen e punëve teknike si kusht për udhëheqjen e procedurës administrative në DPU për qështje të lejes së ndërtimit.

b) mbikqyrësi për zbatim të projektit – detyrat:

- mbikqyrja e realizimit të projektit dhe raportimi kontraktorit për ecurinë e punimeve;
- paraqitja me kohë e vërejtjeve investitorit lidhur me të gjitha qështjet që bien ndesh me këtë kontratë, lidhur me zbatimin e projektit, veprimtarinë e përcaktuar, respektimi i afateve për ndërtimin.

Obligimet e shfrytëzuesit të tokës ndërtimore

Neni 4

- 4.1 Investitori ndërtimin e objektit industrial – afanist do ta bëjë në përputhje me standardet teknike të përcaktuara me Ligjin e Ndërtimit (2003/15) dhe Rregulloren Komunale për ndërtimin nr 2002/86 të datës 04/09/2002.
- 4.2 Investitori brenda afatit përgatitor prej 6 muajsh nga dita e lidhjes së kësaj kontrate duhet të përgatitë projektin kryesor për objektin investiv duke iu përmbajtur projektit ideor sipas të cilit është përzgjedhur si subjekt fitues i tokës ndërtimore në shfrytëzim afatgjatë dhe kushteve të lokacionit të përcaktuara nga organi kompetent (DPU) njëkohësisht duke siguruar edhe pëlqimin për VNM nga organi kompetent (MMPH).
 - 4.2.1 Investitori brenda kësaj periudhe në çfardo momenti që e kompletin dokumentacionin mund të paiset me lejen e ndërtimit dhe të filloj punimet (pra edhe para 6 muajve nëse arrijnë të përgatitet).
- 4.3 Dokumentacioni teknik do të shqyrtohet dhe miratohet nga DPU në bazë të të cilit edhe lëshohet leja e ndërtimit.
- 4.4 Miratohen vetëm ato dokumentacione (projekte) që janë të hartuara në përputhje me standardet projektuese dhe nga ndërmarrjet e licencuara sipas kushteve të përcaktuara me LPH dhe LN.
- 4.5 Investitori brenda afatit 6 muajsh është i obliguar të paguaj në buxhetin e Komunës vlerën e caktuar për shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore sipas Rregulloreve përkatëse në shumë prej 0.50 € (pesëdhjetë cent) për 1 m².
- 4.6 Para dhënies së lejes së ndërtimit nga DPU, investitori bënë kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore sipas Rregulloreve përkatëse nr 432/28 të datës 29/12/2005 në shumë prej 1.2 € për m³ të objektit investiv.
- 4.7 DPU shqyrton dokumentacionin teknik dhe brenda 15 ditësh pas dorëzimit lëshon lejen e ndërtimit (gjithsesi të gjitha këto procedura zhvillohen brenda afatit përgatitor 6 muajsh neni 4.2) dhe në rast të intervenimeve të domosdoshme në projekt me rekomandim të mbikqyresit DPU mund të zgjatë afatin shtesë vetëm deri në 30 ditë nga dita e njoftimit të investitorit për këto qeshkje.
- 4.8 Në rast të zgjatjes së afatit për përgatitje të dokumentacionit – DPU i njofton palët kontraktuese.

Afati për realizim të projektit

Neni 5

- 5.1 Me të përfunduar të afatit përgatitor (neni 4.2) fillon afati i realizimit të programit investiv.
- 5.2 Programi investiv në ndërtimin e "Qendres tregtare dhe veprimtarisë shërbyese të tipit mac-donalds" duhet të zbatohet brenda 3 viteve.
 - 5.2.1 Afati për realizim të projektit fillon të rrjedh që nga dita e marrjes së lejes së ndërtimit sipas nenit 4.7 të kësaj kontrate.
- 5.3 Afati për zbatim të projektit (neni 5.2) do të thotë edhe periudhë kur objekti duhet të lëshohet në përdorim dhe të filloi veprimtaria afariste.
 - 5.3.1 Objekti konsiderohet i përfunduar vetëm atëherë kur bëhet shqyrtimi teknik dhe lëshohet leja e përdorimit.
 - 5.3.2 Shpenzimet për shqyrtim teknik të objektit i bartë investitori.
- 5.4 Afatet e përcaktuara mund të shtyhen vetëm në raste të vis majour, pengesave të caktuara administrative dhe në raste të veganta që Komuna merr si të arsyeshme me njoftim paraprak të investitorit dhe miratim të Komunës.
 - 5.4.1 Shtyerje e afatit nuk konsiderohet asnjë rast për të cilin Komuna nuk e ka miraturar në formë të shkruar.

Zbatimi i Projektit

Neni 6

- 6.1 Investitori projektin duhet ta zbatojë në përputhje me dokumentacionin dhe lejen e ndërtimit.
- 6.2 Investitori informon mbikqyrësin zyrtar për të gjitha veprimet në terren – fillimin e punëve, përfundimin e fazave të caktuara të ndërtimit etj.
- 6.3 Mbikqyrësi bazuar në planin e veprimit të investitorit dhe të rrjedhës së punës në terren, në çdo tre muaj i raporton me shkrim autoritetit kontraktues.
- 6.4 Investitori duhet ta ndërtojë objektin për llojin e biznesit (veprimtarinë) për të cilin është dhënë toka në shfrytëzim afatgjatë.
- 6.5 Duhet ta respektoj shumën e përcaktuar të investimeve në kapacitetet afariste.

6.6 Teknologjia dhe pajisjet tjera të jenë në përputhje me kushtet e caktuara me pëlqimin për VNM.

6.7 Përveq sipërfaqes ndërtimore duhet të rregullohet edhe hapësira tjetër komunikuese brenda sipërfaqes së caktuar në përputhje me kushtet e lokacionit të caktuar nga DPU.

Të drejtat pronësore

Neni 7

7.1 Komuna e jep në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme për 99 vite pa kompensim por duke e ruajtur të drejtën mbi pronën.

7.1.1 Investitori e regjistron të drejtën e shfrytëzimit të paluajtshme sipas nenit 7.1 në dokumentacionin kadastral – pronësor në organin kompetent komunal.

7.2 Investitori është pronar i të gjitha investimeve si të luajtshme ashtu edhe të paluajtshme në pronën e Komunes që i realizon sipas kësaj kontrate.

7.3 Në bazën e të dhënave kadastrale dhe pronësore të organit kompetent të Komunes regjistrohen të gjitha objektet (investimet) dhe lëshohet dëshmia për investitorin si pronar i tyre.

Transaksionet pronësore

Neni 8

8.1 E drejta e pronësisë së Komunes për pronën e paluajtshme nuk mund të bartet në persona të tjerë e as në investitorin.

8.2 Investitori si pronar i investimeve të tjera në pronën e Komunes sipas kësaj kontrate ka të drejtën e transaksioneve pronësore në kushte të caktuara dhe me pëlqim të Komunes.

8.3 Çdo transaksion sipas nenit 8.2 është i mundshëm vetëm nëse ruhet struktura e investimit dhe ushtrimi i plotë i biznesit për të cilin është dhënë toka në shfrytëzim afatgjatë.

8.4 Brenda afatit të realizimit të projektit (neni 5.2) nuk mund të bëhet asnjë lloj transaksioneve pronësore ndërmjet investitorit dhe personave të tjerë.

8.5 Prona e investitorit (investimet) në toka është e trashëgueshme sipas ligjit në fuqi.

Obligimet e ndërsjella

Neni 9

- 9.1 Me arritjen e kësaj kontrate, Komuna është e obliguar të sigurojë posedimin e pa penguar të paluajtshmërisë investitorit.
- 9.2 Komuna duhet t'i kryej aktivitetet për shënimin e kufinjave të sipërfaqes së dhënë në shfrytëzim sipas nenit 3 të kësaj kontrate.
- 9.3 Krahas realizimit të programeve investive Komuna bënë rregullimin e infrastruktures rrugore dhe kryen aktivitetet tjera sipas nenit 3 të kësaj kontrate.
- 9.4 Investitori mban përgjegjësi të plotë për realizimin e projektit investiv sipas dokumentacionit teknik dhe planit të veprimit.

Shkëputja e njëanshme e kontratës

Neni 10

- 10.1 Mos përmbushja e obligimeve të përcaktuara me këtë kontratë konsiderohet qenësore për shkëputjen e kontratës për dhenjen e tokës në shfrytëzim afatgjatë.
- 10.2 Kontrata mund të shkëputet me pajtim të dyanshëm dhe pa përgjegjësi të caktuar vetëm brenda afatit përgatitor – 6 muaj do të thotë para marrjes së lejes së ndërtimit.
- 10.2.1 Në rast të shkëputjes së kontratës sipas nenit 10.2 të gjitha pasojat në shpenzimet e bëra deri në at moment i barten investitorit.
- 10.3 Komuna në çdo rast e shkëputë kontratën kur investitori nuk përmbanet obligimeve të përcaktuara me nenin 4, nenin 5, nenin 6 dhe 8-4 të kësaj kontrate.

Përgjegjësia

Neni 11

- 11.1 Komuna është përgjegjëse për përmbushjen e obligimeve sipas nenit 9.1, nenit 9.2 dhe nenit 9.3 të kësaj kontrate.
- 11.2 Investitori është përgjegjës për përmbushjen e të gjitha kriterëve të përcaktuara me këtë kontratë.
- 11.3 Në rast se vije deri të shkëputja e kontratës sipas nenit 10, investitori është përgjegjës për kthimin e lokacionit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e tij.

11.4 Investitorit të cilit i shkëputet kontrata, Komuna nuk ia kthen pagesën e taksave sipas nenit 4.4 dhe 4.5 të kësaj kontrate.

Mosmarrëveshjet

Neni 12

12.1 Të gjitha mosmarrëveshjet eventuale ndërmjet Komunes dhe investitorit duhet të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve.

12.2 Për të gjitha çështjet kontestuese të pazgjidhura kompetente do të jetë Gjykata Komunale në Lipjan.

Fuqizimi

Neni 13

13.1 Kjo kontratë hartohet në ekzemplare të mjaftueshëm dhe hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit prej palëve kontraktuese.

13.2 Kopjet e nënshkruara të kontratës i dorëzohen:

- Komunes – Kryetarit, Zyrës së Prokurimit dhe Kryeshefit Ekzekutiv;
- DGJKP;
- DPU;
- Investitorit;

Shtesë: Skica për ndarjen e lokacionit

Palët kontraktuese:

Për Komunën:

Therref Ollivari, Kryetar i Komunes

[Signature]



Investitor:

N.T. "Standard Benz" sh.p.k.
përfaqësues

[Signature]









REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPIJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

ZYRA E KRYETARIT
sektori pronësoro-juridik

Datë	17.04.2019
Referenca	
Për	Fahri Retkoceri, N.T Standard Benz, fshati Llugaxhi
Nëpërmjet	z.Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
Nga	Lumnije Ejupi, Shefe e sektorit pronësoro-juridik
Lënda	Njoftim

Nëpërmjet kësaj shkrese Zyra e Kryetarit-sektori pronësoro-juridik, Ju njofton se bazuar në dispozitat e Kontratës 1-464-154 dt.26.07.2006 për shfrytëzimin afatgjatë prej 99 vitesh të pronës së paluajtshme P-71409036-00164-23 në vendin e quajtur "Branjesh" me kulturë arë e klasit të 4-të me sipërfaqe prej 15000m² Zona kadastrale Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues për 99 vite Standard-Benz Sh dhe gjendjes faktike në teren ka konstatuar se nuk janë përmbushur obligimet nga ana e juaj siç përcaktohen në kontratën e cekur.

Nga raportet e dhëna nga Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit rreth zhvillimeve dhe ndërtimit të objekteve, vërtetohet se N.T "STANDARD BENZ", posedon leje urbane, ka bërë pagesën e shëndrimit të tokës, pagesën e taksës për objekt, është paisur me leje ndërtimi, ka filluar ndërtimin e objektit dhe i ka ndërprerë punimet gjë e cila vërtetohet nga gjendja faktike në këtë parcelë, objekti nuk është ndërtuar fare dhe e njejta parcelë është ngarkuar me hipotekë deri me datë 03.06.2023.

Prandaj duke u bazuar në të dhënat e më sipërme njoftoheni se do të zhvillohen procedurat e më tutjshme ligjore për shkëputjen e kontratës për mos realizimin nga ana e juaj të projektit për ndërtimin dhe funksionalizimin e Qendrës tregtare dhe veprimtari sherbyese e tipit mac-donalds siç përcaktohet me nenin 5 par.5.2 dhe par.5.3 të Kontratës 1-464-154 të dt.26.07.2006, si dhe njëkohësisht kërkojmë nga ana e juaj që mundësisht që para afatit të kryeni obligimet ndaj bankës, në mënyrë që organi kompetent të liron parcelën e cekur nga hipoteka.

Shtojcë:

- Kontrata 1-464-154 të dt.26.07.2006

Me respekt!

1000

Oznaka spisa

Ev.

Ev.

Titulli i shkresës që dërgohet:

Naziv pisma koje se dostavlja:

Numri i shtojcave:

Broj priloga:

Dorëzuar postës më:

Predato na dan:

Në adresë

Na adresu

NT Standard Bank

Lipp 2021

EMËRTIMI I ORGANIT
NAZIV ORGANA

5. From my journal

Vértetoj se sot

Potvrđujem da sam danas

(Data shënohet edhe me fjalë - Datum ispisati slovima)

e kam marrë në dorëzim e shënuar në faqen e parë
primio sam pošiljku ozanačenu na prvoj strani

Marrësi - Primalac

Emri dhe Mbiemri
Ime Prezime

Nënshkrimi/Potpisje:

1. Pasi marrësi nuk gjendet në vendin ku duhej të kryhej dërgesa as pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën e vet, në vendin e punës dorëzimi iu bë anëtarit madhor të familjes së marrësit-kujdestarit të ndërtësës, fqitit-personit që punon në të njejtin vend punë me marrësin

1. Pošto primalac nije zatečen na mestu gde se dostavljanja ima izvršiti posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja u određeno vreme u svom stanu odnosno na radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćinstva, primaoca-nastojniku zgrade-suseda licu zaposlenom na istom radnom mestu s primacom.

(Mbiemri e emri - Prezime i ime)

Vërejtje e dërguesit në rast mosdorëzimi
Napomena dostavljača u slučaju neispоруke

Dorėzuesi - Dostavljač

Emri dhe Mbiemri
Ime Prezime

Nënshkrimi/Dotpisi

2. Pasi marrësi apo anëtarë i familjes së tij refuzoi marrjen, shkresa iu la në banesë-në vendin e punës së marrësit (ju ngjiti në derën e banesës apo të lokalit ku punon marrësi).

2. Pošto je primalac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismeno je dostavljeno u stanu-radnom mestu primaoca (prijebijeno na vratima stana odnosno prostorije gde je primalac zaposlen).

mě ně orěn
dana u Časova

Shaku i refuzimit

Razlog odbijanja

(Nënshkrimi i dërguesit - Potpis dostavljača)

Oni koji se murešiši čišći analizeht one ruk aših nē gjenije
nē nēškural, nēškural dēgizati dake aškur aškakut
pae murešiši vuri nēškural i vet.
Ako je primarne nepismenih ili nije u stinu da se polpiše
sopstojim ga dostavlja, s napomenom zašto primlue nje
slavio svoj polpis.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

Drejtoria për Planifikim , Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Datë: 12.01.2016

Referencë: 8-350-209

4-350-1448

Për: z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit

Nga: Ilir Tasholli, Drejtor i DPUMM-së

Lënda: INFORMACION



Drejtorati për Planifikim , Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit bazuar në kërkesën 8-350-209 të datës 05.01.2016 ,lidhur me aktivitetet përkatësisht ndërtimeve nga subjektet perfituese që ju ka dhënë toka në shfrytëzim nga autoritet komunale në ZK Konjuh. Ju informojmë se subjekte perfituese:

NTP "Standard-Benz"

NTP "Adriatik Commerce"

NTSH "Sodovina" dhe

NTSH "Terma"

- NTP "Standard-Benz" është paisur me leje ndërtimore por nuk ka filluar aktivitetet ndërtimore .
- NTP "Adriatik Commerce", është paisur me leje ndërtimore, aktivitetet ndërtimore nuk i ka zhvilluar perveq qe e ka hequr një shtresë të dheut dhe e ka zhavoruar.
- NTSH "Sodovina" është paisur me leje ndërtimi e ka perfunduar objektin –Konstruksion metalik dhe i mbështjellur me llamarin, dhe nuk është duke zhvilluar asnjë llojë aktiviteti.
- NTSH "Terma" nuk është paisur me leje ndërtimi i cili e ka kaluar afatin kohor të përmbushjes së kontratës duke ju referuar Drejtoratit te prokurimit.

Me respect.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT
Sektori pronësoro-juridik

Më datë	05.1.2016
Referenca	Zyrt/2016
Për	Ilir Tasholli, Drejtor i Drejtoratit për Urbanizëm Planifikim, Mbrojtje të Mjedisit, Lipjan
Nëpërmjet	z.Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
Nga	Lumnije Ejupi, Shefe e sektorit
Lenda	Kërkesë për informim

Lidhur me raportin e dt.29.01.2015, rreth zhvillimeve përkatësisht ndërtimit të objekteve nga subjektet përfituese që ju është dhënë toka komunale në shfrytëzim ZK Konjuh, organi ynë kërkon nga Drejtorati, të na informani me të dhëna se a është ndërmarr ndonjë veprim procedural pas këtij raporti të bërë Kryetarit të Komunës Imri Ahmetit, në lidhje me ndërtimin e objekteve në pronën komunale sipas kontrateve, në mënyrë që organi ynë të harton propozim-Vendimin të shkëputjes së kontratave për seancën e ardhshme të kuvendit më së largu me dt 08.01.2016, si në vijim:

NTP "Standard-Benz" ngastra 164-23,
NTP "Adriatik Comerc" ngastra 164-21,
NTSH "Sodovina" ngastra 164-15
NTSH "Terma" ngastra 263-3,

Shtojcë:

-Raporti dt.29.01.2015



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

Drejtoria për planifikim dhe urbanizëm

Datë:	12.01.2016
Referencë:	Zyrtare
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar I Komunës, Drejtoratit të Prokurimit
Nga:	Hasim Vishesella – Shef Sektori
Përmes:	Ilir Tasholli –Drejtore i DPUMM
Lënda:	RAPORT Rreth zhvillimeve perkatësisht ndërtimit të objekteve nga subjektet perfituese që ju është dhënë toka komunale në shfrytëzim

Me datë 28.01.2015 është bërë një vizitë në Zonën Industriale për të vlerësuar permbushjen e kontratave lidhur me ndërtimin e objekteve të të gjithë përfituesve të pronave komunale. Gjatë vizitës në terren është konstatuar kjo gjendje:

Punët ndërtimore që i kanë përfunduar janë këto subjekte afariste:

- ✚ LESNA,
- ✚ NTG BLENDI,
- ✚ UBT,

Ndërsa në përfundim të ndërtimit të objekteve janë këto subjekte afariste:

- ✚ NTP ALBI,
- ✚ BENAFI, dhe
- ✚ ALFA I DHE BAJRAMI

Subjektet tjera afarsite nga vlerësimi i fundit i gjindjes në terren që shtë realizuar me datë 28.01.2015 nuk i kanë vazhduar punët sipas kontratës që kanë qenë të obliguar.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të dhënat për të gjitha subjektet afarsite

Nr	Subjekti, perfaqesuesi dhe nr. i tel.	Leje urbane	Pagesa e shndërrimit të tokës	Pagesa e taksave për objekt	Leje ndërtimi	Numri i parcelles	Zhvillimi i punimeve
1.	„LESNA” Hashim Deshishku Prishtinë, 044 508 959	PO	PO	PO	PO	164/24 dhe 166/8	E ka përfunduar ndërtimin e objektit dhe e ka lëshuar objektin në përdorim
2.	NTP „ALBI COMMERCE” Zona e Re idustriale Veternik Prishtinë 044-231 808	PO	PO	PO	PO	164/19 dhe 166/6	Ndërtimi i objektit I përfunduar dhe është në përdorim

3.	NTP „STANDARD BENZ” Fahri Retkocari LLugagji 044 112 209 dhe 049 582 100	PO	PO	PO	PO	164/23	Nuk e ka filluar ndërtimin e objektit fare.
4.	ALFA I DHE BAJRAMI Azem Bajrami - Banulië 044259952 dhe 036-242- 030	PO	PO	PO	PO	164/22	E ka perfunduar ndërtimin e objektit.
5.	NNP „ADRIATIC COMERC” Bujar Bucaliu Gjilan 044 121 961	PO	PO	PO	PO	164/21	Nuk e ka vazhduar ndërtimin (vetëm një shtres te dheut e ka hequr dhe mbushur me zhavor dhe e ka nderprerë.
6.	NTP „LINDI DHE PAJTIMI COMPANI” Ramuz Ajeti - Lipjan 044 136 839	PO	PO	PO	PO	164/18	E ka perfunduar vetëm ndërtimin I themeleve dhe muratimi dhe e ka nderpre.
7.	„NTSH SADOVINA” Negjat Fetahu-Sodovinë e Jerrive Viti 044-501-561	PO	PO	PO	PO	164/15	E ka perfunduar ndërtimin objektit montazh dhe e ka nderpre.
8.	SH.P.K. „BENAF” Safet Kuqi, Suharekë 044 401 419 044-184-065	PO	PO	JO vetëm një rate është paguar në shumë prej 24125.80€ (144754.84€- 24125.80€=12059 6.04) Shuma e mbetur per pagesë është edhe 120596.04€	JO	166/7	Ndërtimi I objektit është ndërprerë
10.	NTG „Blendi”	PO	PO	PO	PO	263/2	E ka perfunduar objektin dhe e ka lëshuar në përdorim.
11.	NNP „Kalaja”	JO	JO	JO	JO	164/17	Nuk e ka filluar ndërtimin.
12.	UBT	PO	PO	PO	PO	164/28	Ka ndërtuar objektin dhe është në përdorim
13.	SH.P.K. „B-Ingjnieringu” Atije Idrizaj	PO	PO	PO	PO	164/31	Është paisur me leje ndërtimi.
14.	UBT	PO	PO	PO	PO	164/16	Është përfunduar objekti dhe është lëshuar në përdorim.
15.	NNSH „Terma”	PO	JO	JO	JO	164/4	Vetëm themelet I ka të perfunduara dhe shtyllat në përdhese.
16.	SH.P.K. „Punëtori” Arjan Idrizaj	Ka aplikuar për leje urbane	PO	PO	PO	263	Nuk e ka filluar ndërtimin fare.
17.	NTSH „MIGROS COMERCE”	Ka aplikuar për leje urbane	JO	JO	JO		

18.	Qendra Intermed (QMI)	Midicional	PO	PO	PO	PO	164/10 dhe 166/3	E ka perfunduar etazhen e katërtë dhe ka filluar muratimin mirëpo tani punët janë ndërpre.
-----	--------------------------	------------	----	----	----	----	---------------------	--



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN
- KRYESUESJA -
15 Nr. 06-38
Lipjan, më 21. 03. 2017

Z. _____

Në bazë të nenit 7 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Komunës së Lipjanit,
THËRRAS

Mbledhjen e 38-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit për të mërkurën më
29.03.2017 në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit me fillim në ora 10,⁰⁰

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 37-të të Kuvendit
2. Njoftim me gjendjen e sigurisë në Komunën e Lipjanit për 2016
3. Raport i punës i zyrës së Kryetarit dhe i drejtorive komunale për vitin 2016
4. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit nga të tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2016
5. Propozim Vendim për bartjen e të hyrave votanake të Komunës së Lipjanit nga vitet 2015-2016 në vitin 2017
6. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e fermerëve të komunës së Lipjanit
7. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës
8. Propozim Vendim për hartimin e projektit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Lipjanit për periudhën 2018-2023
9. Propozim Vendim për miratimin e planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Komunës së Lipjanit 2017-2020
10. Propozim Vendim për themelimin e dy (2) vend gjuetieve të përbashkëta në territorin e komunës së Lipjanit.
11. Plani i implementimit dhe zbatimit të rekomandimeve nga ZAP
12. Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin 2016
13. Raport për verifikimin e pronave komunale përmes projektit për decentralizim dhe mbështetja të komunave "DEMOS"
14. Informatë mbi implementimin e projekteve të financuar nga DEMOS
 - Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike
 - Plani për investime në hapësira të hapura publike
 - Plani për mobilitet
15. Informatë mbi gjendjen e pronave komunale në ZK Konjuh të cilat janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë

Materialin për pikat e propozuara të rendit të ditës e kemi marrë nga sesanca e kaluar

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT
Sektori pronësoro-juridik

INFORMATË MBI GJENDJEN E PRONAVE KOMUNALE NË ZONËN KADASTRALE KONJUH QË JANË DHËNË NË SHFRYTËZIM AFATGJATË

Komuna pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore që janë zbatuar në vitet e mëparshme u ka dhënë në shfrytëzim afatgjatë subjekteve afariste pronat-tokat në zonën kadastrale Konjuh, siq përshkruhen në vijim:

1. Parcela kadastrale P-71409036-00164-4 me sipërfaqe prej 19090m² (një hektar e nëntëdhjetë ari e nëntëdhjetë metra), e cila me Marrëveshjen për dhënien në shfrytëzim të paluajtshmërisë Nr.ref.16303009058611 e datës 17.10.2009, i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit sh.p.k "PUNËTORI"-me pronar Luan Prenku nga Prishtina, për projektin "Qendra distribuive farmaceutike".

- Investitori nuk iu ka përmbajtur obligimeve të tij kontraktuese.

Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronësoro-juridik është konstatuar se ka filluar ndërtimi i objekteve.

2. Parcela kadastrale P-71409036-00164-31 me sipërfaqe prej 19090m² (një hektar e nëntëdhjetë ari e nëntëdhjetë metra), e cila me Marrëveshjen për dhënien në shfrytëzim të paluajtshmërisë Nr.ref.16303009058611 të datës 19.09.2009, i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit sh.p.k "B-INGJINIERINGU", për hartimin dhe zbatimin e projektit "Ndërtimi i tri sërave dhe prodhimin e perimeve të hershme".

- Investitori nuk iu ka përmbajtur obligimeve të tij kontraktuese.

Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronësoro-juridik është konstatuar se ka filluar ndërtimi i objekteve.

3. Parcela kadastrale P-71409036-00164-10 me sipërfaqe prej 45700m² (katër hektar e pesëdhjetë e shtatë ari) dhe parcela kadastrale P-71409036-00166-3 me sipërfaqe prej 4300m² (katërdhjetë e tre ari) të cilat me Kontratën 1-463-322 të datës 04.10.2007, i janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit sh.p.k "INTERMED"-me pronar Fatmir Dalladaku nga Prishtina për zbatimin e programit(projektit)"Qendra medicinale Intermed".
- Investitori nuk iu ka përmbajtur obligimeve të tij kontraktuese.
- Për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuese nga sh.p.k "INTERMED", Kuvendi Komunal me Vendimin 15Nr.464-11830 të datës 04.03.2016 e ka anuluar Vendimin 1Nr.464-331 të datës 23.10.2003 dhe e ka shkëputur kontratën.
- Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso-ro-juridik është konstatuar se investitori nuk i ka kthyer në gjendjen e mëparshme parcelat kadastrale sipas Vendimit të Kuvendit Komunal, gjendja mbetet e njëjtë si më herët kur e ka përfunduar etazhën e katërt të ndërtimit të vrazhdë dhe i ka ndërprerë punimet.
4. Parcela kadastrale P-71409036-00164-15 me sipërfaqe prej 13000m² (një hektar e tridhjetë ari) e cila me Kontratën për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme 1-464-157 të datës 26.07.2006 i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit NTPSH "SADOVINA" me seli në Viti përfaqësuar nga Nexhat Fetahu, për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e profileve të çelikut, karrocave të dorës, gypave, valorizimin e llamarinës së zingtuar dhe kuposjes së llamarinave.
- Investitori nuk iu ka përmbajtur obligimeve të tij kontraktuese.
- Për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuese nga NTPSH "SADOVINA", Kuvendi Komunal me Vendimin 15Nr.464-5849 të datës 01.02.2016 e ka anuluar pjesërisht Vendimin 1Nr.464-123 të datës 20.06.2006 dhe e ka shkëputur kontratën.
- Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso-ro-juridik është konstatuar se investitori nuk e ka kthyer në gjendjen e mëparshme parcelën kadastrale dhe gjendja mbetet e njëjtë si më herët kur e ka përfunduar ndërtimin e objektit montazhë prej llamarine dhe i ka ndërprerë punimet.
5. Parcela kadastrale P-71409036-00164-16 me sipërfaqe prej 17000m² (një hektar e shtatëdhjetë ari) dhe parcela kadastrale P-71409036-00164-28 me sipërfaqe prej 15000m² (një hektar e pesëdhjetë ari) të cilat me Marrëveshjen për dhënien në shfrytëzim të paluajtshmërisë Nr.ref.16303009058611 e tetorit 2009, i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit Universiteti Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji-UBT përfaqësuar nga Edmond Hajrizi-president i UBT-së.
- Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso-ro-juridik është konstatuar se Partneri Privat UBT e ka përfunduar ndërtimin e Qendrës Ndërkombëtare për Edukimin dhe Transfer Teknologjik të Kosovës, duke ofruar mundësinë e studimeve në drejtimet e ndryshme.

6. Parcela kadastrale P-71409036-00164-17 me sipërfaqe prej 10093m² (një hektar e nëntëdhjetë e tri metra), e cila me Marrëveshjen për dhënie në shfrytëzim të paluajtshmerisë Nr.ref.16303009058611 e tetorit 2009, i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh partnerit privat NNP "Kalaja" dhe sh.p.k "Toni" përfaqësuar nga Fejzullah Lushtaku, por pas kërkesës së datës:11.10.2011 të parashtruar nga partneri privat kjo marrëveshje është shkëputur me Aktvendimin e Kryetarit të Komunës INr.464-5423 të datës 14.10.2011.
Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me datë 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso- juridik është konstatuar se në këtë parcelë nuk ka ndërtime dhe e njëjta është e lirë.

7. Parcela kadastrale P-71409036-00164-18 me sipërfaqe prej 15092m² (një hektar e pesëdhjetë ari e nëntëdhjetë e dy metra), e cila me me Kontratën për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme I-464-163 të datës 27.07.2006, i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit N.T.P "LINDI MARKET me seli në Lipjan përfaqësuar nga Ramiz Ajeti dhe "PAJTIMI COMPANY" me seli në Prishtinë përfaqësuar nga Ilmi Konushevci, për hartimin dhe zbatimin e projektit "Fabrikë për përpunimin e plastikës prej granulatit".
- Shfrytëzuesi nuk iu ka përmbajtur obligimeve të tij kontraktuese.
Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me datë 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso- juridik është konstatuar se partneri privat N.T.P "LINDI MARKET dhe "PAJTIMI COMPANY" e ka përfunduar ndërtimin e themelit dhe një pjesë të mureve të jashtme të objektit dhe i ka ndërprerë punimet.

8. Parcela kadastrale P-71409036-00164-19 me sipërfaqe prej 18500m² (një hektar e tetëdhjetë e pesë ari) dhe parcela kadastrale P-71409036-00166-6 me sipërfaqe prej 6500m² (gjashtëdhjetë e pesë ari) të cilat me Kontratën për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme I-464-155 të datës 26.07.2006, i janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit NTP "Albi Commerce" përfaqësuar nga Sytki Humolli, për zbatimin e programit(projektit) "Qendër tregtare dhe fabrikë për përpunimin dhe paketimin e qajrave".
Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me datë 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso- juridik është konstatuar se partneri privat Albi Commerce ka përfunduar ndërtimin e objektit të cilin e shfrytëzon si depo(magazinë) për distribuimin dhe ruajtjen e mallit.

9. Parcela kadastrale P-71409036-00164-20 me sipërfaqe prej 17643m²(një hektar e shtatëdhjetë e gjashtë ari e katërdhjetë e tri metra) dhe parcela kadastrale P-71409036-00166-7 me sipërfaqe prej 12357m² (një hektar e njëzetë e tre ari e pesëdhjetë e shtatë metra), të cilat me Kontratën për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme I-464-164 të datës 01.08.2006, i janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit sh.p.k "BEN-AF" përfaqësuar nga Naim Kuqi nga Suhareka, për zbatimin e programit(projektit) "Qendër tregtare dhe fabrikë për prodhimin e produkteve nga brumërat dhe konzervimi i mishit".
- Shfrytëzuesi nuk iu ka përmbajtur obligimeve të tij kontraktuese.
Për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuese nga sh.p.k "BEN-AF", Kuvendi Komunal me Vendimin 15Nr.464-11834 të datës 04.03.2016 e ka anuluar pjesërisht Vendimin INr.464-123 të datës 20.06.2006 dhe ia ka shkëputur kontratën.

Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso-ro-juridik është konstatuar se investitori nuk e ka kthyer në gjendjen e mëparshme parcelën kadastrale konform obligimit të tij sipas Vendimit të Kuvendit dhe gjendja mbetet e njëjtë si më herët kur ka qenë në ndërtimin e sipër të objektit dhe i ka ndërprerë punimet. Sh.p.k "BEN-AF" ka inicuar procedurë gjyqësore në Gjykatën kompetente kundër Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.464-11834 të datës 04.03.2016.

10. Parcela kadastrale P-71409036-00164-21 me sipërfaqe prej 15000m² (një hektar e pesëdhjetë ari) e cila me Kontratën për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme 1-464-159 të datës 26.07.2006 i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit N.P.T "ADRIATIC COMMERCE" me seli në Gjilan përfaqësuar nga Bujar Bucaliu, për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e telit, sustave dhe dyshekëve.

- Shfrytëzuesi nuk iu ka përmbajtur obligimeve të tij kontraktuese.

Për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuese nga N.P.T "ADRIATIC COMMERCE", Kuvendi Komunal me Vendimin 15Nr.464-5843 të datës 01.02.2016 e ka anuluar pjesërisht Vendimin 1Nr.464-159 të datës 26.07.2006 dhe e ka shkëputur kontratën. Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me datë 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso-ro-juridik është konstatuar se investitori nuk e ka kthyer në gjendjen e mëparshme parcelën kadastrale dhe gjendja faktike mbetet e njëjtë si më herët kur e ka hequr vetëm shtresën e dheut, e ka mbushur me zhavor dhe i ka ndërprerë punimet, ndërsa në dy nënparcelat ndodhet mekanizmi për prodhimin e betonit i cili nuk funksionon dhe disa hekurishte.

Me Aktvendimin e lëshuar nga Zyra e Kryetarit me datë 21.10.2009 parcela 00164-21 është ndarë në dy nënparcela: 00164-26 me sipërfaqe prej 2500m² (njëzetë e pesë ari) e cila në kundërshtim me kontratën bazë i është ndarë sh.p.k "BENTOKOSI I RI" dhe parcela 00164-27 me sipërfaqe prej 2500m² (njëzetë e pesë ari) i është ndarë sh.p.k "N.N.T MASA-HGE". Ky Aktvendim dhe kontratat e lidhura ndërmjet partnerëve privat janë anuluar me Vendimin e Kuvendit Komunal 15Nr.464-17262 i datës 05.04.2016.

11. Parcela kadastrale P-71409036-00164-22 me sipërfaqe prej 15000m² (një hektar e pesëdhjetë ari) e cila me Kontratën për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme 1-464-158 e datës 26.07.2006 i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit N.N.P "ALFA.I & AB-BAJRAMI" me seli në Istog e përfaqësuar nga Halil Jahaj dhe Azem Bajrami, për realizimin e programit investiv(projektit) "Kompleks industrial për prodhimin e pjesëve fazonike nga çeliku".

Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me datë 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso-ro-juridik është konstatuar se partneri privat N.N.P "ALFA.I & AB-BAJRAMI" ka përfunduar ndërtimin e objektit, të cilin e shfrytëzon për zyrë inxhinierike përfshirë shërbimet administrative, financiare, menaxheriale etj, ndërsa pjesën tjetër e shfrytëzon si depo për material të ujësjellësit dhe kanalizimit.

12. Parcela kadastrale P-71409036-00164-23 me sipërfaqe prej 15000m² (një hektar e pesëdhjetë ari) e cila me Kontratën për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme 1-464-154 të datës 26.07.2006, i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit N.T"STANDARD BENZ" sh.p.k, përfaqësuar nga Fahri Retkoceri nga fsh.Llugaxhi, për zbatimin e programit investiv(projektit) "Qendër tregtare dhe veprimtari shërbyese e tipit mac-donalds". Është pajisur me leje ndërtimore me datë 10.09.2008.

- Shfrytëzuesi nuk iu ka përmbajtur obligimeve të tij kontraktuese.

Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me datë 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso- juridik është konstatuar se partneri privat N.T"STANDARD BENZ" nuk ka filluar fare ndërtimin e objektit.

Parcelën komunale që e ka marrë në shfrytëzim e ka ngarkuar me hipotekë deri me 03.06.2023.

13. Parcela kadastrale P-71409036-00164-24 me sipërfaqe prej 28910m² (dy hektar e tetëdhjetë e nëntë ari e dhjetë metra) dhe parcela kadastrale P-71409036-00166-8 me sipërfaqe prej 1090m² (dhjetë ari e nëntëdhjetë metra), të cilat me Kontratën për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme 1-464-153 të datës 26.07.2006, i janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit N.P.Q"LESNA" sh.p.k, përfaqësuar nga Hashim Deshishku me seli në Prishtinë, për zbatimin e programit investiv(projektit) "Fabrikë për prodhimin e dyerve dhe dritareve të drurit dhe plastikës".

Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me datë 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso- juridik është konstatuar se partneri privat N.P.Q"LESNA" e ka përfunduar ndërtimin e objektit të cilin e shfrytëzon për prodhimin e kuzhinave, mobiljeve dhe orendive të ndryshme.

14. Parcela kadastrale P-71409036-00263-2 me sipërfaqe prej 9320m² (nëntëdhjetë e tre ari e njëzetë metra, prej së cilës 20m² është shpronësuar nga Departamenti i Shpronësimit për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit), e cila me Marrëveshjen për dhënien në shfrytëzim të paluajtshmërisë Nr.ref.16303009058611 e tetorit 2009, i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit NTG "BLENDI"-përfaqësuar nga Shaip Rama nga Prishtina për hartimin dhe zbatimin e projektit për ndërtimin e shtypshkronjës.

Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me datë 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronëso- juridik është konstatuar se partneri privat e ka përfunduar dhe e ka lëshuar objektin në përdorim.

15. Parcela kadastrale P-71409036-00263-3 me sipërfaqe prej 9780m² (nëntëdhjetë e shtatë ari e tetëdhjetë metra), prej së cilës 2144m² është shpronësuar nga Departamenti i Shpronësimit për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit), e cila me Marrëveshjen për dhënien në shfrytëzim të paluajtshmërisë Nr.ref.16303009058611 e datës 19.10.2009, i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh fituesit NNSH "TERMA"-përfaqësuar nga Yll Kastrati nga Prishtina, për hartimin dhe zbatimin e projektit për prodhimin e kalldajave, bojlerëve dhe kolektorëve solar.

- Shfrytëzuesi nuk iu ka përmbajtur obligimeve të tij kontraktuese.

Gjendja faktike: Pas vizitës në teren me datë 03.02.2017 nga zyrtarët e sektorit pronësoro-juridik është konstatuar se NNSH "TERMA" ka përfunduar themelet e objektit dhe shtyllat e betonit në përdhese.


Bashkëngjitur këtij raporti iu dërgojmë të gjitha fotot e parcelave kadastrale që janë dhënë në shfrytëzim të përshkruara në këtë informatë.

INr. 991-6456


Datë: 20.02.2017

Kryetari i Komunës

Imri Ahmeti



ATP-2100, HACKETT THE PRINTING COMPANY



22 09 2015

01 APR 2016 11:30 AM



08 01 2016

ZYRA E KRYETARIT
sektori pronëso-ro-juridik

Datë	22.05.2018
Referenca	
Për	N.T.P "Lindi Market"-pronar Ramiz Ajeti rr"Avdi Avdiu"-Lipjan dhe "Pajtimi Company"-pronar Ili Konushevi adresa: rr"Bajram Baftiri" 57 Prishtinë
Nëpërmjet	z.Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Nga	Lumnije Ejupi-shefe e sektorit pronëso-ro-juridik
Lënda	Njoftim

Nëpërmjet kësaj shkrese Zyra e Kryetarit-sektori pronëso-ro-juridik ju njofton se bazuar në dispozitat e Kontratës 1-464-163 dt.27.07.2006 për shfrytëzimin afatgjatë prej 99 vitesh të ½ të pronës së paluajtshme P-71409036-00164-18 në vendin e quajtur "Branjesh" me kulturë arëe klasit të4-të me sipërfaqe prej 15092m² Zona kadastrale Konjuh, nga N.T.P "Lindi Market"-pronar Ramiz Ajeti rr"Avdi Avdiu"-Lipjan dhe "Pajtimi Company"-pronar Ili Konushevi adresa: rr"Bajram Baftiri" 57 Prishtinë dhe gjendjes faktike në terren ka konstatuar se nuk janë përmbushur obligimet nga ana e juaj siq përcaktohen në Kontratën e përmendur.

Obligimet kryesore që nuk janë përmbushur nga ana e juaj konsistojnë në:

- Mospërfundimin e punimeve gjë e cila vërtetohet edhe me fotot që janë bërë nga zyrtarët e sektorit pronëso-ro-juridik në zonën kadastrale Konjuh.
- Mospërfundimin dhe mosfunksionalizimin e objektit "Fabrikë për përpunimin e plastikës prej granulatit", brenda 3 vitesh pas marrjes së Lejes ndërtimore Nr.9-351-342 me datë 13.11.2008, konform nenit 5 par.5.2 dhe par.5.3 të kontratës, por nuk e keni përmbushur këtë detyrim.
- Mosnjoftimin me shkrim nëse keni qenë i penguar për shkaqe objektive që ta realizoni investimin e juaj, në mënyrë që të iu mundësohet vazhdimi i ndonjë afati të Kontratës.

Prandaj bazuar në arsyet e lartëcekura dhe të tjera të Kontratës ju njoftojmë se do të inicohet procedura e shkëputjes së Kontratës, kështu që brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese në mënyrë vullnetare ti ndërmerri veprimet e nevojshme për rrënimin e objektit dhe kthimin e gjendjes së mëparshme në parcelën nr. 00164-18 ZK Konjuh.

FLETËKTHESA - POVRATNICA

Numri i shkresës
Oznaka spisa 1-463-32407
Ev.
Ev.

Titulli ishskresës që dërgorhet:
Naziv pisma koje se dostavlja: Njshkrim

Numri i shtojcave:
Broj priloga: 1

Dorëzuar postës më:
Predato na dan: Lipjor

Në adresë
Na adresë Njsh. Kuvendit

Prilozhi

Ko: Bofendi Bafendi - Prilozhi

KOMUNA E LIPIJANIT
OPŠTINA LIPIJAN

EMËRTIMI I ORGANIT
NAZIV ORGANA

S. Bofendi Juridit
G. Hetem

Vërtetohet se sot
Potvrđujem da sam danas (Data shënohet edhe me fjalë - Datum ispisati slovima)

e kam marrë në dorëzim e shënuar në faqen e parë
primio sam pošiljku ozanačenu na prvoj strani

Marrësi - Primalac

Emri dhe Mbiemri
Ime Prezime
Nënshkrimi/Potpisi

1. Pasi marrësi nuk gjendet në vendin ku duhej të kryhej dërgesa as pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën e vet, në vendin e punës dorëzimi iu bë anëtarit madhor të familjes së marrësit-kujdestarit të ndërtesës, fqit-personit që punon në të njëjtin vend pune me marrësin

1. Pošto primalac nije zatečen na mestu gde se dostavljanja ima izvršiti posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja u određeno vreme u svom stanu odnosno na radnom mestu, dostava je izvršena odraslom članu domaćinstva, primaoca-nastojniku zgrade-suseda licu zaposlenom na istom radnom mestu s primaocem.

(Mbiemri e emri - Prezime i ime)

Vërejtje e dërguesit në rast mosdorëzimi
Napomena dostavljača u slučaju neispоруke

Dorëzuesi - Dostavljač

Emri dhe Mbiemri
Ime Prezime
Nënshkrimi/Potpisi

2. Pasi marrësi apo anëtar i familjes së tij refuzoi marrjen, shkresa iu la në banesë në vendin e punës së marrësit (i u ngjiti në derën e banesës apo të lokalit ku punon marrësi).

2. Pošto je primalac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu-radnom mestu primaoca (pribijeno na vratima stana odnosno prostorije gde je primalac zaposlen).

më në orën
dana u Časova

Shaku i refuzimit
Razlog odbijanja

(Nënshkrimi i dërguesit - Potpis dostavljača)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruaj, nënshkrimi dërguesi duhet shkruar shkakun për marrësin e vuri nënshkrimin e vet.
Ako je primalac nepismen ili nije u stanu/da se potpis ne može da dostavljač, s napomenom zašto primalac nije stavio svoj potpis.

(Të panevojshme bjeru vizë - Nepotrebno precrtati)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPIJANT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT
sektori pronësoro-juridik

Datë	17.04.2019
Referenca	
Për	Fabri Retkoceri, N.T Standard Benz, fshati Llugaxhi
Nëpërmjet	z.Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
Nga	Lumnije Ejupi, Shefe e sektorit pronësoro-juridik
Lënda	Njoftim

Nëpërmjet kësaj shkrese Zyra e Kryetarit-sektori pronësoro-juridik, Ju njofton se bazuar në dispozitat e Kontratës 1-464-154 dt.26.07.2006 për shfrytëzimin afatgjatë prej 99 vitesh të pronës së paluajtshme P-71409036-00164-23 në vendin e quajtur "Branjesh" me kulturë arë e klasit të 4-të me sipërfaqe prej 15000m² Zona kadastrale Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues për 99 vite Standard-Benz Sh dhe gjendjes faktike në teren ka konstatuar se nuk janë përmbushur obligimet nga ana e juaj siç përcaktohen në kontratën e cekur.

Nga raportet e dhëna nga Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit rreth zhvillimeve dhe ndërtimit të objekteve, vërtetohet se N.T "STANDARD BENZ", posedon leje urbane, ka bërë pagesën e shëndrimit të tokës, pagesën e taksës për objekt, është paisur me leje ndërtimi, ka filluar ndërtimin e objektit dhe i ka ndërprerë punimet gjë e cila vërtetohet nga gjendja faktike në këtë parcelë, objekti nuk është ndërtuar fare dhe e njejta parcelë është ngarkuar me hipotekë deri me datë 03.06.2023.

Prandaj duke u bazuar në të dhënat e më sipërme njoftoheni se do të zhvillohen procedurat e më tutjshme ligjore për shkëputjen e kontratës për mos realizimin nga ana e juaj të projektit për ndërtimin dhe funksionalizimin e Qendrës tregtare dhe veprimtari sherbyese e tipit mac-donalds siç përcaktohet me nenin 5 par.5.2 dhe par.5.3 të Kontratës 1-464-154 të dt.26.07.2006, si dhe njëkohësisht kërkojmë nga ana e juaj që mundësisht që para afatit të kryeni obligimet ndaj bankës, në mënyrë që organi kompetent të liron parcelën e cekur nga hipoteka.

Shtojcë:

- Kontrata 1-464-154 të dt.26.07.2006

Me respekt!

T-200

EMËRTIMI I ORGANIT
NAZIV ORGANA

Dr. Thomas J. Hall
C. Hays

Art Standard Bent
Lippman

e kam martë në dorëzim e shënuar në faqen e parë
primio sam pošiliku ozanačenu na prvoj strani

Dorēzuesi - Dostavljač

(Nënshkrimi i dërguesit - Potpis dostavljača)

Verejtje e dërguesit në rast mosdorëzimi
Napomena dostavljača u slučaju neispоруke

Të panevojshme bjeri vizë - Nepotrebno precrati)

Ako je primatice nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, s napomenom zašto primačac nije stavio svoj potpis.